



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Prill 2019

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujo

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nentor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill 2019

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2019
Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Prill 2019 arriti në 107.6 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Prill 2019 ishte 1.4 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Prill 2019 ishte 110.57 lekë për dollarë dhe 124.34 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Prill 2019 shënuan kuotën 0.48 për qind për ato 12 –muajore; 0.52 për qind për depozitat 6-mujore; 0.18 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.62 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 6.23 për qind për huatë 12-mujore dhe 6.87 për qind për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në rreth 1.271.731 milionë lekë në muajin Prill, duke shënuar një rritje prej rreth 3.3 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e parë të 2019-ës shënoi rënie të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën -70.7 milionë euro.
- *Situata Buxhetore për periudhën Janar-Prill 2019 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 2.958 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar 0.3 miliardë lekë.*
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara gjatë periudhës Janar- Prill 2019, arritën në rreth 149.148 miliardë lekë ose afërsisht 99.5% e planit për këtë periudhë.*
- *Shpenzimet gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 146.191 miliardë lekë ose 97.5% e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.*


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Prill 2019 ishte +1.4%. Ndërsa, një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte +2.1%. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Prill 2019 shënoi rënie prej 0.2 për qind krahasuar me muajin paraardhës, gjithashtu në muajin Shkurt 2019 pësoi rënie prej 0.3 për qind. Ndërsa përgjatë muajit Shkurt 2019, indeksi ka shënuar rritje prej 0.6 për qind në krahasim me muajin paraardhës përkatës. Përsa i përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Prill 2018 shënoi rënie prej 0.5 për qind në krahasim me muajin paraardhës.

Krahasuar me muajin Prill 2018, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 2.7%, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1.2%, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1.1%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 1.0%, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Shërbimi arsimor” me 0.7% secili, “Transport” me 0.4% etj.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoritë “Argëtim dhe kulturë” dhe “Shëndeti” kanë



ndikuar negativisht në inflacionin e përgjithshëm përgjatë muajit Prill 2019, përkatësisht me 1.1% dhe 0.3%.

Ndryshimi mujor i indeksit është -0.2%. Krahasuar me muajin Mars 2019, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u ulën me 0.7%, pasuar nga grupi “Argëtim dhe kulturë” me 0.6%. Ndërsa, çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” u rritën me 0.2%, pasuar nga grupet “Shëndeti” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0.1% respektivisht.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2018	1.7	2.1	2.0	2.1	2.1	2.4	2.3	2.2	2.1	1.9	1.8	1.8
2019	1.9	1.7	1.1	1.4								

Burimi: INSTAT


2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Prill 2019, arriti në 124.34 lekë/euro, duke shënuar rënie në vlerë me 0.53 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Prill, një euro u këmbye me 123.38 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Prill 2019 arriti në 110.57 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 0.04 për qind kundrejt muajit Mars 2019. Në fund të muajit Prill, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 110.09 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin Prill të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 3.82 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmuar në masën 5.01 për qind. Forcimi i lekut në dy vitet e fundit është nxitur nga përshpejtimi relativ i rritjes ekonomike në vend, pritjet për vazhdimin e kësaj tendence në të ardhmen dhe reduktimi i primit të rrezikut për ekonominë tonë.

Fig-2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Prill 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë


Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.89 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Prill 2019, normat e interesit të depozitave me afat 1 mujore dhe 6 mujore shënuan vlerat më të larta prej 0.62 dhe 0.52 për qind, pasuar nga ato me afat 12 dhe 3 mujore që arritën përkatësisht kuotën 0.48 dhe 0.18 për qind.

Normat e interesit të depozitave 3, 12 dhe 6 mujore kanë pësuar rënie mujore prej përkatësisht 0.13, 0.09 dhe 0.04 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit të depozitave 1 mujore kanë shënuar rritje me 0.07 pikë përqindje.

Fig. 3




Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 1 dhe 3 mujore, kanë pësuar rënie prej përkatësisht 0.29, 0.29 dhe 0.08 pikë përqindje, ndërsa ato me afat maturimi 6 nuk kanë pasur ndryshim.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit Prill 2019 arritën përkatësisht kuotën prej 6.87 dhe 6.23 për qind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje mujore prej 0.34 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit 6 mujore kanë pësuar rënie mujore me 0.82 pikë përqindje. Duke krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 12 mujore kanë shënuar rritje me 2.09 pikë përqindje, ndërsa ato 6 mujore kanë pësuar rënie me 0.84 pikë përqindje.

Fig-4




Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 mujore gjatë muajit Prill 2019 arritën nivelin 1.11 për qind duke shënuar kështu rënie mujore prej 0.03 për qind dhe rënie vjetore prej 1.25 për qind.

4. Bilanci i Pagesave


Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e parë të vitit 2019 pësoi rënie të mjeteve valutore, me rreth 70.7 milionë euro. Tremujori i parë i 2019-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej rreth 243 milionë euro, dhe vlerësohet në rritje në terma vjetore me rreth 41%. Deficiti tregtar u zgjerua me rreth 13%, në nivelin 406 milionë euro. Shkalla e ekspozimit të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 226 milionë euro në rritje me 72 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Fluksi hyrës neto në llogarinë financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënon 289 milionë euro dhe mbulon plotësisht deficitin korrent. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.



Bilanci i Pagesave per T1 - 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë periudhës transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,610 milionë euro dhe janë zgjeruar me 7% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente shënon 243 milionë euro, në rritje vjetore me rreth 41%. Ecuria e deficitit korrent në këtë tremujor, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar të mallrave dhe balancës negative të të ardhurave parësore, pasojë e ecurisë në rritje të riatdhësimit të fitimeve dhe dividendëve. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2019 (Fig-6):



Llogaria Korente per T1 - 2019


Burimi: Banka e Shqipërisë

- (i) bilanci tregtar me -243.3 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 288.8 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -28.9 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 191.2 milionë euro.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit Prill 2019, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 40.995 milionë lekë krahasuar me muajin Prill të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto bankës qendrore me rreth 41.325 milionë lekë.

Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rënie me 16.712 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rënia mujore prej 18.389 milionë lekë e bankës qendrore.




Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1.271.731 milionë lekë në muajin Prill 2019, duke shënuar rritje prej rreth 40.783 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.3 për qind.

Në muajin Prill 2019, sistemi bankar rezulton me rënie prej 6.230 milionë lekë ose -0.5 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.




6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Prill 2019 arriti në rreth 545.775 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 314 milionë lekë, ose rënie prej rreth 0.06 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (50.2%) dhe monedhave të huaja (49.8%).



Gjatë muajit Prill 2019, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 59.7 për qind ose 326.015 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 34.28 për qind ose 187.091 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 3.85 dhe 2.02 për qind apo 20.993 dhe 11.039 milionë lekë.




Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin Prill 2019, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 72.34 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 23.99 për qind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.0 për qind dhe rreth 1.68 për qind.

7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 273.146 milionë lekë në fund të muajit Prill 2019. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Prill 2019 ka pësuar rënie mujore prej 0.02 për qind si dhe rritje vjetore prej 0.95 për qind, duke arritur nivelin 21.5 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rënie mujore prej 0.03 për qind dhe rritje vjetore prej 1.53 për qind, duke shënuar nivelin 27.4 për qind.

Fig-11




Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Prill 2019, kanë shënuar rritje prej 23.438 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 80.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa depozitat në Lekë gjatë muajit Prill 2019 shënuan rritje prej 3.150 milionë lekë në krahasim me muajin Prill 2018. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 83 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë


8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Prill 2019, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 83 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 12.8 për qind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 2.4 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 80.8 për qind dhe rreth 16.8 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 81.8 për qind e totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 816.813 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (149.357 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (16.287 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (14.568 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.559 milionë lekë) në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Prill 2019, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 998.585 miliardë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave pësoi rënie prej rreth 4.645 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 20.289 milionë lekë.


Fig-13



Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-14



Përberja e depozitave Prill 2019

Burimi: Banka e Shqipërisë


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar-Prill 2019 janë mbledhur rreth 149.148 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 146.191 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 129.973 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 16.183 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 32% janë financime të huaja.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 97.755 miliardë lekë (ose rreth 97% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 9.627 miliardë lekë (ose rreth 135% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 32.649 miliardë lekë (ose rreth 99.3% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 7.692 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit për periudhën Janar-Prill 2019).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 129.973 miliardë lekë, 24.484 miliardë lekë (18.8% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 12.029 miliardë



lekë (9.3%) për shpenzime interesi, 13.835 miliardë leke (10.6%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 430 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 52.749 miliardë lekë (40.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 17.966 miliardë lekë (13.8%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 7.566 miliardë lekë (5.8%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 30% (shpenzime personeli), 29% (shpenzime për interesat), 30% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 29% (subvencione), 31% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 35% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 32% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 20%, ndërsa financimi i huaj është 13% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar-Prill 2019 ishin rreth 149.148 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 140.451 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 7.692 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Prill 2019 (mld Lekë) Revenues during April 2019 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Prill '19 April '19	Prill '18 April '18	Ndrysh(%) Chang (%)
	TVSH (VAT)	11.1	10.9	2.1
	Taksa doganore (Custom Tax)	0.5	0.4	18.7
	Akcizat (Excise)	3.3	3.3	0.5
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	3.6	3.3	7.2
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	3.2	2.8	13.1
	Taksat nacionale (National Tax)	2.8	2.6	6.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Prill – 2019

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: April– 2019

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 2.958 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Prill 2019, u përdor kryesisht për huamarrjen e brendshme, si mjeti kryesor i financimit të brendshëm dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin Prill 2019, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 41.060 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 41.647 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin Prill 2019, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 38.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë muaj, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 34.6 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 6.9 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019	
Janar	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.4	0.9	1.5	1.5	1.6	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	January
Shkurt	2.4	1.1	0.5	0.8	0.6	1.9	1.0	1.0	1.0	1.1	2.3	0.2	2.2	2.1	1.7	February
Mars	0.4	0.5	0.4	0.3	-0.3	1.4	0.8	0.8	0.9	0.6	2.2	0.3	2.1	2.0	1.1	March
Prill	-0.5	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	0.9	0.5	0.5	0.5	0.4	2.3	0.3	1.9	2.1	1.4	April
Maj	-1.6	-1.2	-1.2	-1.2		0.3	0.2	0.1	0.2		1.8	0.7	2.0	2.1		May
Qershor	-1.1	-0.6	-0.4	-0.1		0.1	0.04	0.0	0.1		1.4	1.2	2.2	2.4		June
Korrik	-0.7	0.0	-0.1	-0.3		0.1	0.20	0.0	0.1		1.3	1.9	2.0	2.3		July
Gusht	0.8	0.9	0.4	0.4		0.1	0.21	0.1	0.1		1.9	2.0	1.6	2.2		August
Shtator	0.6	0.4	0.4	0.2		0.2	0.17	0.1	0.1		2.2	1.8	1.6	2.1		September
Tetor	0.0	-0.2	0.0	-0.2		0.2	0.13	0.1	0.1		2.1	1.5	1.9	1.9		October
Nëntor	-0.3	0.1	-0.1	-0.2		0.1	0.12	0.1	0.1		2.1	1.9	1.7	1.8		November
Dhjetor	0.6	0.9	1.0	1.1		0.17	0.19	0.2	0.2		2.0	2.2	1.8	1.8		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019				Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	
					January	February	March	April	
<i>Mesatarja e periudhës</i>									<i>Average of period</i>
USD	126.64	128.29	112.56	108.43	108.92	109.73	110.53	110.57	USD
EURO	137.65	135.27	133.25	123.45	124.39	124.56	124.99	124.34	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>									<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.58	110.51	111.67	110.09	USD
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	124.64	125.92	125.34	123.38	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2015	2016	2017	2018	2019				In percent
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Norma e depozitave									Deposits rates
12-M	1.27	0.78	0.80	0.75	0.73	0.68	0.57	0.48	12-M
6-M	1.17	0.78	0.56	0.56	0.45	0.45	0.56	0.52	6-M
3-M	0.54	0.27	0.29	0.30	0.24	0.25	0.31	0.18	3-M
1-M	0.88	0.87	0.82	0.62	0.65	0.71	0.55	0.62	1-M
Norma e huasë									Lending rates
12-M	7.47	4.54	6.79	6.34	6.76	5.89	5.89	6.23	12-M
6-M	8.35	7.01	8.12	8.16	7.63	7.50	7.69	6.87	6-M
Norma e letrave me vlerë									Securities rates
Bono thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	-	-	-	-	-	3-M
6-M	2.46	2.00	-	-	-	1.07	-	0.85	6-M
12-M	2.40	2.92	2.63	1.43	1.33	1.25	1.14	1.11	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2019

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	34,532	68,709	108,088	149,148	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	244	447	659	1,006	Grants
II.	Të ardhura tatimore	33,030	64,587	101,552	140,451	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	22,638	44,928	72,773	97,755	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,971	21,550	32,380	43,518	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	Profit Tax
3	Akcizat	2,900	6,025	9,863	13,230	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,677	6,593	9,376	12,651	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,068	5,871	8,092	11,118	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	410	840	1,411	1,966	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	1,353	3,173	4,909	9,627	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	221	431	817	2,279	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	1	5	27	252	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,131	2,737	4,066	7,096	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	9,038	16,486	23,870	33,069	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	7,711	14,064	20,421	28,194	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,271	2,213	3,167	4,454	Health insurance
III.	Të ardhura Jotatimore	1,258	3,675	5,876	7,692	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë			576	576	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	712	2,623	3,842	5,091	Income of budgetary institutions
	TOTAL I SHPENZIMEVE	32,422	67,532	104,543	146,191	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	28,971	61,789	95,344	129,973	Current Expenditures
I.1	Personeli	5,949	12,033	18,305	24,484	Personnel expenditures
1	Paga	5,100	10,314	15,679	20,991	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	844	1,693	2,570	3,419	Social insurance contributions
I.2	Interesat	4,047	6,750	9,525	12,029	Interest
1	Të Brendshme	2,846	4,922	6,977	8,836	Domestic
2	Të Huaja	1,200	1,828	2,547	3,193	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,487	5,479	9,028	13,835	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	74	203	359	430	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	12,387	25,873	40,017	53,663	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	9,547	19,193	29,265	39,652	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,376	5,890	9,963	13,097	Health insurance
I.6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	2,701	8,096	12,669	17,966	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,327	3,354	5,441	7,566	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	33	76	130	180	Unemployment insurance benefits
I.8	Transferime Kapitale				35	
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca					Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	3,451	5,743	9,199	16,183	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	2,583	3,237	6,029	11,250	Domestically financing
2	Financimi Huaj	863	2,457	3,101	4,776	Foreign financed
IV	Detyrimet e prapambetuara					Arrears
V.	DEFICITI	2,110	1,178	3,545	2,958	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-2,110	-1,178	-3,584	-2,958	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-1,502	-2,468	-3,348	1,825	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	28	33	47	64	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-5,900	-7,329	-2,600	799	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	4,375	4,828	-795	961	Others
V.3	I huaj	-608	1,291	-197	-4,783	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,403	2,488	2,919	4,268	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nënhua	98	130	285	304	Subsidiary Loan
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-684	-343	-164	-138	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	-	1,400	1,400	1,400	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2019

Table of investments 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Financim i brendshëm	- 1,502	- 2,468	- 3,348	1,825	Domestic financing
Në %	71.2	209.58	94.4	-61.71	In %
Financim i huaj	- 608	1,291	- 197	- 4,783	Foreign financing
Në %	28.8	-109.58	5.6	161.71	In %
Totali	-2,110	-1,178	-3,546	-2,958	Total
Në %	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2019
CUSTOMS REVENUES 2019**

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Taksë doganore	410	840	1,411	1,966	Customs Duties
TVSH	6,893	14,742	23,426	32,766	V.A.T
Akcizë	2,900	6,025	9,862	13,229	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	201	356	532	731	Others (Mineral Rent)
TOTALI	10,404	21,963	35,231	48,692	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2019 (TAX REVENUE)

TVSH	4,079	6,808	8,954	10,751	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,613	4,049	11,651	15,272	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,677	6,593	9,376	12,651	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	2,867	5,515	7,560	10,387	National taxes
TOTALI	12,235	22,965	37,541	49,062	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	22,639	44,928	72,772	97,754	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2019

The Deficit and Its Financing for 2019

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
TË ARDHURAT	34,532	68,715	108,088	149,148	REVENUE
SHPENZIMET	32,422	67,533	104,543	146,191	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,110	1,182	3,545	2,958	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,110	-1,182	-3,545	-2,958	FINANCING
Financimi i brendshëm	-1,502	-2,473	-3,348	1,825	Domestic
a. Bono Thesari Neto	-1,799	-2,038	-2,192	-3,413	Treasury bills
b. Obligacione	-4,088	-5,266	-368	4,265	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	13,883	14,155	12,003	11,117	Chang. of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	13,689	13,289	11,926	10,666	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	193	866	77	451	Deposit of Social & Health Ins.
d. Mjete në ruajtje	418	340	501	743	Non-budget revenues
e. Të ardhura nga privatizimi	28	33	47	64	Privatization receipts
f. Të tjera detyrime	-9,926	-9,671	-13,298	-10,898	Others
g. Huamarrje Brendshme Vendori	-14	-25	-40	-53	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-608	1,291	-197	-4,783	Foreign
a. Hua afatgjatë	1,403	2,488	2,919	4,268	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-684	-343	-164	-138	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,327	-2,254	-4,352	-10,313	Repayments
d. Mbeshtetje Buxhetore	0	1,400	1,400	1,400	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	3M_I_2019	
Llogaria korente	-1,026.70	-1,303.20	-1,160.50	-811.60	-865.60	-859.70	-243.30	Current Account.
Bilanci tregtar	-1,729.30	-2,136.60	-2,298.80	-2,602.80	-2,824.10	-2,871.00	-694.40	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	925.30	771.10	713.70	797.10	986.10	209.50	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-3,061.90	-3,069.90	-3,316.50	-3,621.20	-3,857.10	-903.90	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	8.90	268.40	502.80	796.60	1,081.90	1,104.00	288.80	Services Balance.
Shërbimet Kredi	1,655.00	2,031.50	2,028.20	2,395.70	2,856.20	3,065.80	674.30	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	1,763.10	1,503.30	1,599.10	1,774.30	1,961.80	385.50	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-8.40	-159.60	-133.00	174.10	28.90	-5.40	-28.90	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	193.30	110.60	126.00	408.70	407.70	398.00	80.20	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-270.20	-259.00	-234.60	-378.80	-403.40	-109.10	Income Debt
Bilanci i transfertave	702.10	724.60	768.50	820.50	847.70	912.70	191.20	Balance of Transfers
Transferta private	681.40	851.80	921.50	961.20	961.80	1,002.90	219.20	Private Unrequired Transfers
Transferrat shtetërore	20.70	-127.20	-153.00	-140.70	-114.10	-90.20	-28.00	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	47.70	86.70	125.70	66.20	122.30	104.00	17.50	Capital Account
Llogaria financiare	775.60	-956.30	-1,326.20	-664.30	-1,115.30	-1,145.30	-288.50	Financial Account
Investime direkte	893.10	-801.30	-823.00	-936.50	-993.80	-1,026.00	-279.40	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	120.80	-324.80	225.20	-100.00	-75.10	-0.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-275.80	-88.50	187.40	49.00	-50.30	-9.30	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	315.30	311.00	296.00	128.90	-186.30	-18.20	-133.50	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	111.90	50.80	259.50	47.80	185.70	371.40	-70.80	Overall Balance
		0.00	0.00					
Rezervat	-104.40	97.20	609.60	47.70	185.40	371.50	-70.70	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	46.40	89.90	140.40	70.50	-6.10	-0.30	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019				Millions of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Mjetet valutore neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	394,586.1	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	407,654.7	418,562.1	417,605.4	436,487.8	428,969.2	431,419.9	437,560.5	419,740.9	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	41,991.5	28,949.4	26,917.8	24,043.3	24,812.0	24,846.7	24,585.7	25,154.8	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	63,394	65,915.7	59,998	21,779	24,331	23,987	28,805	30,047	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	48,752	34,255.6	18,407	-12,366	277	4,001	4,820	2,883	Claims on Central Government
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	75,143.9	53,279.9	52,839.5	55,628.9	56,113.1	55,325.8	56,343.6	56,163.1	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	26,391.9	19,024.3	34,432.8	67,994.8	55,836.4	51,324.7	51,523.7	53,280.4	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera deponituese	12,237.0	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,648.9	1,725.7	1,720.0	1,827.2	1,847.0	1,878.3	1,940.4	1,982.9	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	383,972.8	414,380.9	452,243.1	423,427.9	413,895.1	412,381.9	423,488.7	411,205.9	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	451.8	194.0	146.6	80.6	81.3	85.2	85.7	80.8	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	34.2	47.2	96.8	285.4	246.0	96.1	110.1	183.2	Other accounts payable
Të tjera neto	-18,792	-20,953.6	-20,683	-20,659	-20,670	-20,836	-20,839	-20,830	Other items net
Aksione	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	38,832.9	38,933.6	33,992.8	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

KREDIA PËR EKONOMINË

Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019				Million of Lek End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Totali i kredisë	546,873	547,602.4	550,280.4	532,628.2	536,695.9	541,549.5	547,343.2	545,775.0	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1	662.6	656.7	638.3	Credits to local Government
Në Lekë	887.7	845.5	787.7	539.0	677.1	662.6	656.7	638.3	in Lek
Në valutë	-	-	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	27,419.7	26,863.9	29,515.4	20,270.1	20,810.7	19,834.9	21,416.8	20,993.0	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	22,326.1	23,993.9	24,453.5	16,594.2	16,799.0	15,785.0	16,830.4	16,439.4	in Lek
Në valutë	5,093.6	2,870.0	5,061.9	3,675.9	4,011.7	4,049.9	4,586.4	4,553.6	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	355,725.2	343,483.0	334,762.9	317,722.0	320,223.3	324,487.5	326,947.9	326,014.50	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	129,233.7	131,743.5	136,075.7	127,999.7	127,162.2	127,938.4	129,000.0	129,532.10	in Lek
Në valutë	226,491.5	211,739.5	198,687.2	189,722.3	193,061.1	196,549.1	197,947.9	196,482.40	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	9,537.7	8,687.6	7,944.6	10,164.0	10,234	10,433	11,102	11,039	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	5,036.2	4,242.3	3,522.3	4,802.1	4,738	4,893	5,418	5,610	in Lek
Në valute	4,501.5	4,445.3	4,422.3	5,361.9	5,495.9	5,539.9	5,684.0	5,428.3	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	153,303.1	167,722.4	177,269.8	183,933.1	184,750.5	186,131.9	187,219.6	187,090.7	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	83,319.7	98,722.3	108,419.1	118,744.1	119,297.6	119,772.1	121,019.2	121,927.5	in Lek
Në valutë	69,983.4	69,000.1	68,850.7	65,189.0	65,452.9	66,359.8	66,200.4	65,163.2	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019				Millions of LEK End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Baza monetare	383,972.8	414,380.9	425,243.1	423,427.9	413,895.1	412,381.9	423,488.7	411,205.9	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	15.3	7.9	2.6	-0.4	2.7	3.3	7.9	1.1	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave depozituese	239,218.1	249,256.5	265,156.0	275,281.4	271,542.9	272,762.3	274,731.9	273,146.2	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	9.9	4.2	6.4	3.8	5.5	5.9	8.0	8.1	Y/Y change in %
Depozita	687,292.6	737,808	741,157	745,304	755,851.1	756,964.1	755,099.9	755,297.3	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	-29.7	7.3	0.5	0.6	2.0	2.7	3.7	3.9	Y/Y change in %
Agregati M1	384,106.9	435,432.3	461,550.1	478,717.6	481,254.7	483,695.2	487,483.1	485,576.6	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	8.7	13.4	6.0	3.7	6.5	6.6	9.9	9.1	Y/Y change in %
Agregati M2	723,975.7	736,944.1	738,900.0	731,352.3	732,038.2	733,256.7	735,846.3	732,066.0	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	0.2	1.9	0.3	-1.0	0.9	1.1	2.9	2.4	Y/Y change in %
Agregati M3	1,218,101.2	1,263,453.8	1,266,906.9	1,263,928.1	1,274,889.0	1,278,601.6	1,277,962.4	1,271,731.6	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	1.9	3.9	0.3	-0.2	1.3	2.1	3.2	3.3	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare									Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	365,663.3	389,612.7	390,687.6	412,444.5	404,157.2	406,573.1	412,974.7	394,586.1	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	63,394.2	65,915.7	59,998.0	21,779.0	24,330.7	23,987.1	28,804.5	30,046.7	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	48,752.0	34,255.6	18,406.7	-12,365.8	276.7	4,001.1	4,819.9	2,882.7	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019				Millions of Leks End of Period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Në lekë	493,374	487,687	473,744	456,071	460,495	460,495	461,115	458,920	In national currency
Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë	153,506	186,176	196,394	203,436	209,712	210,933	212,751	212,431	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	1,473.8	1,907.5	1,344.4	1,482.1	1,294.7	1,200.9	1,476.8	1,412.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	8,736.2	6,786.0	8,656.7	8,861.1	9,710.2	9,420.3	10,020.0	9,225.3	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,258.9	2,071.0	2,524.8	2,586.8	3,014.7	4,205.9	2,986.3	2,996.0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	40,993.6	46,051.0	48,979.3	49,221.4	53,372.8	51,109.0	50,917.1	50,672.4	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	101,043.0	129,360.4	134,889.0	141,284.9	142,319.5	144,996.9	147,351.0	148,124.8	Other resident sectors
Depozita të tjera	339,869	301,512	277,350	252,635	250,783	249,562	248,363	246,489	Other deposits
Qeveria lokale	29.9	18.9	15.2	13.1	12.8	12.9	12.9	12.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	815.0	976.8	705.2	1,634.7	1,707.0	1,709.3	1,641.2	1,641.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,573.4	7,553.4	9,282.1	5,050.5	4,126.7	3,937.3	3,903.6	3,834.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	11,292.1	6,502.2	9,062.4	9,687.0	9,171.0	9,030.8	8,529.0	8,145.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	324,158.3	286,460.2	258,285.1	236,249.4	235,765.9	234,871.3	234,276.6	232,854.9	Other resident sectors
Në valutë	193,918	250,121	267,413	289,233	295,356	296,470	293,985	296,377	In foreign currency
Qeveria lokale	209.5	366.1	139.8	113.4	147.7	179.2	111.2	134.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,645.4	2,999.4	2,086.3	1,407.7	1,711.8	1,696.6	1,951.2	1,932.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	2,641.2	1,815.4	3,756.9	3,616.6	3,561.2	3,872.6	3,389.4	4,776.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	53,618.9	73,325.0	74,187.3	78,055.3	81,182.5	78,009.9	74,801.6	78,221.9	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	133,803.4	171,614.8	187,242.7	206,039.8	208,752.6	212,711.2	213,732.0	211,312.5	Other resident sectors
Totali	687,293	737,808	741,157	745,304	755,851	756,964	755,100	755,297	Total
Qeveria lokale	1,713.2	2,292.5	1,499.4	1,608.6	1,455.2	1,393.0	1,600.9	1,559.0	Local governments
Korporata jofinanciare publike	13,196.6	10,762.2	11,448.2	11,903.5	13,129.0	12,826.2	13,612.4	12,798.7	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	7,473.5	11,439.8	15,563.8	11,253.9	10,702.6	12,015.8	10,279.3	11,607.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	105,904.6	125,878.2	132,229.0	136,963.7	143,726.3	138,149.7	134,247.7	137,040.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	559,004.7	587,435.4	580,416.8	583,574.1	586,838.0	592,579.4	595,359.6	592,292.2	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH

Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2015	2016	2017	2018	2019				Millions of Lek End of period
					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
AKTIVET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941	527,659	538,818	523,989	
Total	126,386	131,887	187,367	209,596	197,631	196,817	196,257	182,805	Total
Mbajtjet e SDR	30,578.8	27,211.8	25,725.3	19,625.0	20,028.7	20,136.8	20,082.1	19,429.1	SDR holdings
Arka në valutë	84.9	52.0	24.3	67.1	18.7	27.3	23.1	71.7	Foreign currency
Depozitat	95,722.4	104,622.9	161,617.3	189,904.2	177,584.0	176,652.6	176,151.8	163,303.7	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	323,679	315,113	259,538	261,577	266,052	268,535	276,156	271,030	Securities other than shares
Jorezident	270,453.6	261,877.5	206,818.9	205,990.4	209,990.6	213,275.2	219,896.0	214,966.7	nonresidents
Qeveria qendrore	53,225.5	53,235.2	52,718.8	55,586.8	56,061.0	55,259.3	56,259.7	56,063.7	central government
Huatë	14,641	31,660	41,591	34,145	24,054	19,985	23,983	27,162	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,987.1	29,934.4	39,871.3	32,317.6	22,207.0	18,107.7	22,044.2	25,181.2	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,654.0	1,725.9	1,719.8	1,827.1	1,846.5	1,876.8	1,938.4	1,981.1	Other resident secotrs
Derivatet financiare	27.7	15.8	11.7	19.3	43.6	19.5	22.7	49.7	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	32,741.6	25,094.1	23,844.9	21,224.9	21,648.6	21,649.0	21,744.8	22,304.0	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	18,882.5	20,961.2	20,574.7	20,542.0	20,512.4	20,654.7	20,655.4	20,637.8	Nonfinancial assets
DETYRIMET	516,358	524,731	532,927	547,104	529,941	527,659	538,818	523,989	LIABILITIES
Total	241,006	262,031	278,611	286,209	282,051	284,100	285,742	285,165	Total
Para në qarkullim	239,218.1	258,848.0	274,711.8	286,158.4	281,990.3	282,878.3	285,643.3	284,907.8	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	1,787.9	3,183.2	3,899.2	50.6	61.1	1,221.3	99.0	257.1	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	201,586	191,380	200,514	222,292	204,765	196,705	206,357	196,710	Deposits excluded from broad money
Jorezident	31,826.2	19,860.9	19,350.9	17,047.3	17,053.6	17,051.9	17,039.5	17,359.7	Nonresidents
Qeveria qendrore	26,340.8	18,975.1	34,384.3	67,945.2	55,786.6	51,285.7	51,485.8	53,228.4	Central government
Korporata të tjera depozituese	142,966.8	152,349.7	146,632.1	137,218.8	131,843.7	128,282.3	137,746.5	126,041.1	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	87.4	72.1	66.7	49.6	50.3	54.2	54.6	54.1	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	364.4	121.9	79.9	31.0	31.0	31.0	31.0	26.7	
Huatë	1,810	314	116	18	0	0	0	0	-
Jorezidentët	1,809.6	314.2	115.6	18.3	0.1	0.0	-	-	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	461.1	1,164.6	463.8	518.7	1,122.0	834.8	571.5	1,032.3	Other accounts payable
Alokimi i SDR	8,104.4	7,981.2	7,340.5	6,977.7	7,066.3	7,186.4	7,213.5	7,088.9	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	63,391.1	61,859.9	45,882.2	31,088.6	34,935.9	38,832.9	38,933.6	33,992.8	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania